

Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 33

Fitimet për aksion

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij Standardi është të përshkruajë parimet për përcaktimin dhe paraqitjen e fitimeve për aksion, në këtë mënyrë të përmirësojë krahasimin e performancës midis njësive ekonomike të ndryshme në të njëjtën periudhë raportimi dhe midis periudhave të ndryshme të raportimit për të njëjtën njësi ekonomike. Megjithatë të dhënat e fitimeve për aksion kanë kufizime sepse mund të përdoren politika kontabël të ndryshme për përcaktimin e 'fitimeve', një emërues i përbashkët i vendosur qëndrueshëm përmirëson raportimin financiar. Fokusi i këtij Standardi është në llogaritjen e emëruesit të përbashkët të fitimeve për aksion.

Objekti

- 2 Ky Standard zbatohet për
- (a) pasqyrat financiare individuale të një njësie ekonomike:
- (i) aksionet e zakonshme ose aksionet e zakonshme potenciale të së cilës tregtohen në një treg publik (në bursa të vendit apo të huaja ose në një treg jashtë bursave, përfshirë tregjet rajonale dhe vendore) ose
- (ii) që deklaron, apo është në procesin e deklarimit, të pasqyrave të tij financiare në komisionin e letrave me vlerë ose organizëm tjetër rregullator për qëllimin e emetimit të aksioneve të zakonshme në një treg publik; dhe
- (b) pasqyrat financiare të konsoliduara të një grupi me një shoqëri mëmë:
- (i) aksionet e zakonshme ose aksionet e zakonshme potenciale të së cilës tregtohen në një treg publik (në bursa të vendit apo të huaja ose në një treg jashtë bursave, përfshirë tregjet rajonale dhe vendore) ose
- (ii) që deklaron, apo është në procesin e deklarimit, të pasqyrave të tij financiare në komisionin e letrave me vlerë ose organizëm tjetër rregullator për qëllimin e emetimit të aksioneve të zakonshme në një treg publik.
- 3 Një njësi ekonomike që jep informacione shpjeguese për fitimet për aksion do të llogarisë dhe japë informacione shpjeguese për fitimet për aksion në përputhje me këtë Standard.
- 4 Kur një njësi ekonomike paraqet edhe pasqyra financiare të konsoliduara edhe pasqyra financiare të veçanta të përgatitura në përputhje me SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara* dhe SNK 27 *Pasqyrat financiare individuale*, dhënia e informacioneve shpjeguese që kërkohen nga ky Standard duhet të paraqitet vetëm mbi bazën e informacioneve të konsoliduara. Një njësi ekonomike që zgjedh të japë informacione shpjeguese për fitimet për aksion në pasqyrat e saj financiare individuale paraqet këtë informacion për fitimet për aksion vetëm pasqyrën e saj individuale të të ardhurave gjithëpërfshirëse. Njësia ekonomike nuk i paraqet këto informacione të fitimeve për aksion në pasqyrat financiare të konsoliduara.
- 4A Nëse një njësi ekonomike paraqet zëra të fitimit ose humbjes në një pasqyrë të veçantë të fitimit ose humbjes nga pasqyra që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse siç përshkruhet në paragrafin 12(b) të SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*, ajo paraqet fitimet për aksion vetëm në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

Përkufizimet

- 5 Termat e mëposhtëm janë përdorur në këtë Standard sipas kështyre kuptimeve specifike:
- Kundërpaksimi* është rritja e fitimeve për aksion ose ulja e humbjes për aksion që rezulton nga supozimi që instrumentet e konvertueshme janë konvertuar, që opsionet apo garancitë janë ushtruar, apo që aksionet e zakonshme janë emetuar kundrejt plotësimit të kushteve të caktuara.
- Marrëveshja aksionit të kushtëzuar* është një marrëveshje për të emetuar aksione që varet nga plotësimi i kushteve të caktuara.

Aksione të zakonshme të emetueshme me kusht janë aksione të zakonshme të emetueshme për pak apo aspak mjete monetare kundrejt plotësimit të kushteve të caktuara në një marrëveshje aksioni të kushtëzuar.

Pakësimi është një ulje në fitimet për aksion ose një rritje në humbjen për aksion e cila rezulton nga supozimi që instrumentet e konvertueshme janë konvertuar, që opsionet apo garancitë janë ushtruar, ose që aksionet e zakonshme janë emetuar kundrejt plotësimit të kushteve të caktuara.

Opsionet, garancitë dhe ekuivalentët e tyre janë instrumente financiarë që i japin të drejtën zotëruesit për të blerë aksione të zakonshme.

Një *aksion i zakonshëm* është një instrument i kapitalit të vet që i nën renditet të gjitha klasave të tjera të instrumenteve të kapitalit të vet.

Një *aksion i zakonshëm potencial* është një instrument financiar ose kontratë tjetër që mund t'i japë të drejtën zotëruesit të tyre për aksione të zakonshme.

Opsionet për të shitur të aksioneve të zakonshme janë kontrata që i japin të drejtën zotëruesit të shesë aksione të zakonshme me një çmim të caktuar për një periudhë të dhënë.

- 6 Aksionet e zakonshme marrin pjesë në fitimin e periudhës vetëm pasi llojet e tjera të aksioneve të tilla si aksionet preferenciale kanë marrë pjesë. Njësia ekonomike mund të ketë më shumë se një klasë të aksioneve të zakonshme. Aksionet e zakonshme të së njëjtës klasë kanë të njëjtat të drejta për të marrë dividendë.
- 7 Shembuj të aksioneve të zakonshme potencialë janë:
 - (a) detyrimet financiare ose instrumentet e kapitalit, përfshirë aksionet preferenciale, që janë të konvertueshme në aksione të zakonshme;
 - (b) opsionet dhe garancitë;
 - (c) aksionet të cilat mund të emetohen kundrejt plotësimit të kushteve që vijnë nga dispozitat kontraktuale, të tilla si blerja e një biznesi apo e aktiveve të tjera.
- 8 Termat e përkufizuara në SNK 32 *Instrumentet financiarë: Paraqitja* përdoren në këtë standard sipas kuptimeve të specifikuara në paragrafin 11 të SNK 32, përveç rasteve kur vihet në dukje e kundërta. SNK 32 jep përkufizimet e instrumentit financiar, aktivitetit financiar, detyrimit financiar, dhe instrumentit të kapitalit neto dhe vlerës së drejtë, dhe jep udhëzime për zbatimin e këtyre përkufizimeve. SNRF 13 *Matja me vlerën e drejtë* përkufizon vlerën e drejtë dhe përcakton kërkesat për zbatimin e këtij përkufizimi.

Matja

Fitimet bazë për aksion

- 9 Njësia ekonomike llogarit shumat e fitimeve bazë për aksion sipas fitimit ose humbjes që i atribuohen zotëruesve të aksioneve të zakonshme të njësisë ekonomike mëmë dhe, në qoftë se paraqitet, fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme që i atribuohen këtyre zotëruesve të kapitalit të vet.
- 10 Fitimet bazë për aksion llogariten duke pjesëtuar fitimin ose humbjen që i atribuohet zotëruesve të aksioneve të zakonshme të njësisë ekonomike mëmë (numëruesi) me numrin mesatar të pandërruar të aksioneve të zakonshme të emetuara (emëruesi) gjatë periudhës.
- 11 Objektivi i informacionit të fitimeve bazë për aksion është të japë një matje të interesave të secilit aksion të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë në performancën e njësisë ekonomike gjatë periudhës raportuese.

Fitimet

- 12 Për qëllimet e llogaritjes së fitimeve bazë për aksion, shumat që i atribuohen zotëruesve të kapitalit neto të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë në lidhje me:
 - (a) fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme që i që i takon njësisë ekonomike mëmë; dhe
 - (b) fitimin ose humbjen që i takon njësisë ekonomike mëmë
 duhet të jenë shumat në (a) dhe (b) të rregulluara për shumat pas-tatimit të dividendëve preferencialë, diferencave që vijnë nga shlyerja e aksioneve preferencialë dhe efekte të tjera të ngjashme të aksioneve preferencialë të klasifikuar si kapital i vet.

- 13 Të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që i atribuohen zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë që janë njohur në një periudhë, përfshirë shpenzimin për tatimin dhe dividendët e aksioneve preferencialë të klasifikuara si detyrime, përfshihen në përcaktimin e fitimit ose humbjes të periudhës që i atribuohet zotëruesve të kapitalit neto të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë (shih SNRF 18).
- 14 Shuma pas-tatimit e dividendëve preferencialë që i zbritet fitimit ose humbjes është:
- (a) shuma pas-tatimit e çdo dividendi preferencial për aksionet preferenciale jo-kumulative të deklaruar në lidhje me periudhën; dhe
 - (b) shuma pas-tatimit e dividendëve preferencialë për aksionet preferencialë kumulative që kërkohet për periudhën, edhe nëse dividendët janë deklaruar ose jo. Shuma e dividendëve preferencialë të periudhës nuk përfshin shumën e ndonjë dividendi preferencial për aksione preferencialë kumulativë të paguara ose të deklaruar gjatë periudhës aktuale dhe që lidhen me periudhat e mëparshme.
- 15 Aksionet preferenciale që japin një dividend të ulët në fillim për të kompensuar një njësi ekonomike për shitjen e aksioneve preferenciale me zbritje, ose dividendi më i lartë se tregu në periudhat e mëvonshme për të kompensuar investitorët për blerjen e aksioneve preferenciale me një prim, nganjëherë referohen si aksione preferenciale me normë rritëse. Çdo emetim fillestar me zbritje ose me prim i aksioneve preferenciale me normë rritëse amortizohet në fitimet e pashpërndara duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe trajtohet si dividend preferencial për qëllimet e llogaritjes të fitimeve për aksion.
- 16 Aksionet preferencialë mund të riblihen kundrejt një tenderi të njësisë ekonomike ofruar zotëruesve të tyre. Tejkalimi i vlerës së drejtë të shumës së paguar për aksionarët preferencialë mbi vlerën kontabël neto të aksioneve preferencialë paraqet një kthim për zotëruesit e aksioneve preferencialë dhe një zvogëlim në fitimet e pashpërndara të njësisë ekonomike. Kjo shumë zbritet në llogaritjen e fitimit ose humbjes që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë.
- 17 Konvertimet e mëparshme të aksioneve preferencialë të konvertueshëm mund induktohen nga një njësi ekonomike nëpërmjet ndryshimeve favorizuese të kushteve fillestare të konvertimit ose pagesës së shumave shtesë. Tejkalimi i vlerës së drejtë të aksioneve të zakonshme ose shumave të tjera të paguara mbi vlerën e drejtë të aksioneve të zakonshme të emetueshme sipas kushteve fillestare të konvertimit është një kthim për aksionarët preferencialë dhe është një zbritje në llogaritjen e fitimit ose humbjes që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë.
- 18 Çdo tejkalim i vlerës kontabël neto të aksioneve preferencialë mbi vlerën e drejtë të shumave të paguara për të shlyer ato i shtohet llogaritjes së fitimit ose humbjes që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë.

Aksionet

- 19 **Për qëllimet e llogaritjes së fitimeve bazë për aksion, numri i aksioneve të zakonshme është numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme në qarkullim gjatë periudhës.**
- 20 Duke përdorur numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme në qarkullim gjatë periudhës pasqyrohet mundësia që shuma e kapitalit aksionar të ndryshojë gjatë periudhës si rezultat i një numri më të madh ose më të vogël të aksioneve që janë në qarkullim në çdo kohë. Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme në qarkullim gjatë periudhës është numri i aksioneve të zakonshme në qarkullim në fillim të periudhës, i rregulluar me numrin e aksioneve të zakonshme të riblera ose të emetuara gjatë periudhës shumëzuar me një faktor ponderues-kohë. Faktori ponderues-kohë është numri i ditëve që aksionet janë në qarkullim në raport me numrin total të ditëve të periudhës; në shumë rrethana është e përshtatshme të bëhet një përafrim i arsyeshëm i mesatares së ponderuar.
- 21 Aksionet përfshihen zakonisht në numrin mesatar të ponderuar të aksioneve që nga data që shuma është e arkëtueshme (që në përgjithësi është data e emetimit të tyre), për shembull:
- (a) aksionet e zakonshme të emetuara në këmbim të mjeteve monetare përfshihen kur mjetet monetare janë të arkëtueshme;
 - (b) aksionet e zakonshme të emetuara për ri-investim vullnetar të dividendëve në aksione të zakonshme ose preferenciale përfshihen kur dividendët janë ri-investuar;
 - (c) aksionet e zakonshme të emetuara si rezultat i konvertimit të një instrumenti borxhi me aksione të zakonshme përfshihen nga data që ndërpritet llogaritja e interesit;
 - (d) aksionet e zakonshme të emetuara në vend të interesit ose principalit të instrumenteve të tjera financiare përfshihen nga data që ndërpritet llogaritja e interesit;

- (e) aksionet e zakonshme të emetuara në këmbim të shlyerjes së një detyrimi të njësisë ekonomike përfshihen që nga data e shlyerjes;
- (f) aksionet e zakonshme të emetuara për blerjen e një aktivi që nuk është mjete monetare, përfshihen nga data në të cilën është njohur blerja; dhe
- (g) aksionet e zakonshme të emetuara për kryerjen e shërbimeve për njësinë ekonomike përfshihen kur janë kryer shërbimet.

Afatet e përfshirjes të aksioneve të zakonshme përcaktohen nga afatet dhe kushtet që shoqërojnë emetimin e tyre. Trajtimi i duhur bëhet bazuar në thelbin e çdo kontrate që shoqëron emetimin.

- 22 Aksionet e zakonshme të emetuara si pjesë e kostos së një kombinimi biznesi përfshihen në numrin mesatar të ponderuar të aksioneve që nga data e blerjes. Kjo sepse blerësi përfshin në pasqyrën e tij të të ardhurave gjithëpërfshirëse fitimet dhe humbjet e njësisë ekonomike të blerë që nga kjo datë.
- 23 Aksionet e zakonshme që do të emetohen kundrejt konvertimit të një instrumenti të konvertueshëm të detyruar përfshihen në llogaritjen e fitimeve bazë për aksion që nga data që kontrata hyn në fuqi.
- 24 Aksionet e emetueshme me kusht trajtohen si në qarkullim dhe përfshihen në llogaritjen e fitimeve bazë për aksion vetëm nga data kur janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme (d.m.th. ngjarjet kanë ndodhur). Aksionet që janë të emetueshme vetëm me kalimin e kohës nuk janë aksione të emetueshme me kusht, sepse kalimi i kohës është i sigurtë. Aksionet e zakonshme në qarkullim që janë të kthyeshme me kusht (d.m.th. subjekt i rithirrjes) nuk trajtohen si në qarkullim dhe përjashtohen nga llogaritja e fitimeve bazë për aksion deri në datën që aksionet nuk janë më subjekt i rithirrjes.
- 25 [Fshirë]
- 26 **Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme në qarkullim gjatë periudhës dhe për të gjitha periudhat e paraqitura do të rregullohet për ngjarjet, përveç rastit të konvertimit të aksioneve të zakonshme potenciale, të cilat kanë ndryshuar numrin e aksioneve të zakonshme në qarkullim pa një ndryshim korrespondues të burimeve.**
- 27 Aksionet e zakonshme mund të emetohen, ose numri i aksioneve të zakonshme në qarkullim mund të ulet, pa një ndryshim korrespondues të burimeve. Shembujt përfshijnë:
- (a) një emetim kapitalizimi ose emetim bonusi (ndonjëherë i quajtur si një dividend stoku);
 - (b) një element bonusi në ndonjë tjetër emetim, për shembull një element bonusi në një emetim të drejtash për aksionarët ekzistues;
 - (c) një shpërbërje aksioni; dhe
 - (d) një anullim i shpërbërjes së aksionit (konsolidimi i aksioneve).
- 28 Në një emetim kapitalizimi ose bonusi ose në një shpërbërje aksioni, aksionet e zakonshme, emetohen për aksionarët ekzistues pa ndonjë shumë shtesë. Prandaj, numri i aksioneve të zakonshme në qarkullim rritet pa ndonjë rritje të burimeve. Numri i aksioneve të zakonshme në qarkullim para ngjarjes rregullohet proporcionalisht me ndryshimin në numrin e aksioneve të zakonshme në qarkullim sikur ngjarja ka ndodhur në fillim të periudhës më të parë të paraqitur. Për shembull, në një emetim bonusi dy-për-një, numri i aksioneve të zakonshme në qarkullim para emetimit është shumëzuar me tre për të përfutur numrin e ri total të aksioneve të zakonshme, ose me dy për të përfutur numrin e aksioneve të zakonshme shtesë.
- 29 Konsolidimi i aksioneve të zakonshme në përgjithësi ul numrin e aksioneve të zakonshme në qarkullim pa një ulje korresponduese të burimeve. Megjithatë, kur efekti i përgjithshëm është një riblerje aksioni me vlerën e drejtë, ulja në numrin e aksioneve të zakonshme në qarkullim është rezultat i një ulje korresponduese të burimeve. Një shembull është një konsolidim aksioni i kombinuar me një dividend të veçantë. Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme në qarkullim për periudhën në të cilën kryhet transaksioni i kombinuar rregullohet me uljen në numrin e aksioneve të zakonshme nga data që është njohur dividendi i veçantë.

Fitimet e pakësuara për aksion

- 30 Njësia ekonomike do të llogarisë shumat e fitimeve të pakësuara për aksion për fitimin ose humbjen që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë, në qoftë se paraqitet, fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme që i atribuohen këtyre zotëruesve të kapitalit.
- 31 Për qëllimet e llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion, njësia ekonomike do të rregullojë fitimin ose humbjen që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë dhe numrin mesatar të ponderuar të aksioneve në qarkullim, për efektet e të gjitha aksioneve të zakonshme potenciale të pakësueshme.

- 32 Objektivi i fitimeve të pakësuara për aksion është i njëjtë me atë të fitimeve bazë për aksion – për të dhënë një matje të interesit të secilit aksion të zakonshëm në performancën e njësisë ekonomike – si edhe në dhënien e efektit për të gjithë aksionet e zakonshme potenciale të pakësueshme në qarkullim gjatë periudhës. Si rrjedhim:
- (a) fitimi ose humbja që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë rritet për shumën pas-tatimit të dividendëve dhe interesit të njohur në atë periudhë në lidhje me aksionet e zakonshme potenciale të pakësueshme dhe rregullohet për çdo ndryshim tjetër në të ardhura ose shpenzime që mund të vijnë nga konvertimi i aksioneve të zakonshme potenciale të pakësueshme; dhe
 - (b) numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme në qarkullim rritet me numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme shtesë që do të ishin në qarkullim duke supozuar konvertimin e të gjitha aksioneve të zakonshme potenciale të pakësueshme.

Fitimet

- 33 **Për qëllimin e llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion, njësia ekonomike duhet të rregullojë fitimin ose humbjen që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë, siç llogaritet në përputhje me paragrafin 12, me efektin pas-tatimit të:**
- (a) **çdo dividendi ose elementëve të tjerë të lidhur me aksionet e zakonshme potenciale të pakësueshme, të pakësuara për të arritur tek fitimi ose humbja që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë siç llogaritet në përputhje me paragrafin 12;**
 - (b) **çdo interesi të njohur në periudhën e lidhur me aksionet e zakonshme potenciale të pakësueshme; dhe**
 - (c) **çdo ndryshimi tjetër në të ardhurat ose shpenzimet që mund të rezultojnë nga konvertimi i aksioneve të zakonshme potenciale të pakësueshme.**
- 34 Pasi aksionet e zakonshme potenciale të konvertohen në aksione të zakonshme, elementët e identifikuar në paragrafin 33(a)–(c) nuk paraqiten më. Në të kundërt, aksionet e reja të zakonshme kanë të drejtë të marrin pjesë në fitimin ose humbjen që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë. Për këtë, fitimi ose humbja që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë i llogaritur në përputhje me paragrafin 12, rregullohet për elementët e identifikuar në paragrafin 33(a)–(c) dhe çdo tatim të lidhur me të. Shpenzimet e lidhura me aksionet e zakonshme potenciale përfshijnë kostot e transaksionit dhe zbritjet e kontabilizuara në përputhje me metodën e interesit efektiv (shih SNRF 9).
- 35 Konvertimi i aksioneve të zakonshme potenciale mund të çojë në ndryshime pasuese në të ardhura ose shpenzime. Për shembull, ulja e shpenzimeve për interesa që lidhen me aksionet e zakonshme potenciale dhe rritjet që rezultojnë në fitimin ose uljet e humbjes mund të çojë në një rritje të shpenzimeve që lidhen me një plan për ndarje të fitimit jo-diskriminues për të punësuarit. Për qëllimet e llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion, fitimi ose humbja që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë rregullohet për çdo ndrydhim pasues të tillë në të ardhura ose shpenzime.

Aksionet

- 36 **Për qëllimin e llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion, numri i aksioneve të zakonshme duhet të jetë numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme i llogaritur në përputhje me paragrafët 19 dhe 26, plus numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme që mund të emetohen nga konvertimi i të gjitha aksioneve të zakonshme potenciale të pakësueshme në aksione të zakonshme. Aksionet e zakonshme potenciale të pakësueshme duhet të konsiderohen se janë konvertuar në aksione të zakonshme në fillim të periudhës ose, nëse më vonë, në datën e emetimit të aksioneve të zakonshme potenciale.**
- 37 Aksionet e zakonshme potenciale të pakësueshme duhet të përcaktohen në mënyrë të pavarur për secilën periudhë të paraqitur. Numri i aksioneve të zakonshme potenciale të pakësueshme përfshirë në periudhën nga fillimi i vitit deri në momentin aktual nuk është një mesatare e ponderuar e aksioneve të zakonshme potenciale të pakësueshme të përfshira në përlllogaritjet për secilën periudhë të ndërmjetme.
- 38 Aksionet e zakonshme potenciale ponderohen për periudhën që ato janë në qarkullim. Aksionet e zakonshme potenciale që janë anuluar ose lejuar të tërhiqen gjatë periudhës përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion vetëm për pjesën e periudhës gjatë të cilës ato kanë qenë në qarkullim. Aksionet e zakonshme potenciale që janë konvertuar në aksione të zakonshme gjatë periudhës përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion nga fillimi i periudhës deri në datën e konvertimit; nga data e

konvertimit, aksionet e zakonshme që rezultojnë përfshihen edhe në fitimet bazë edhe në fitimet e pakësuar për aksion.

- 39 Numri i aksioneve të zakonshme që mund të emetohen nga konvertimi i aksioneve të zakonshme potenciale të pakësueshme përcaktohet nga kushtet e aksioneve të zakonshme potenciale. Kur ekzistojnë më shumë se një bazë konvertimi, llogaritja merr parasysh normën e konvertimit ose çmimin e ushtrimit më të mirë nga këndvështrimi i zotëruesit të aksioneve të zakonshme potenciale.
- 40 Një filial, sipërmarrje e përbashkët ose pjesëmarrje mund të emetojë për palë të treta, përveç shoqërisë mëmë, sipërmarrësit ose investitorit me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi të investuarin, aksione të zakonshme potenciale që janë të konvertueshme, qoftë në aksione të zakonshme të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes, qoftë në aksione të zakonshme të shoqërisë mëmë, apo investitorëve me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme (njësia raportuese) mbi të investuarin, sipërmarrësit ose investitorit. Nëse këto aksione të zakonshme potenciale të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes kanë efekt pakësues në fitimet bazë për aksion të njësisë raportuese, ato përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuar për aksion.

Aksione të zakonshme potenciale të pakësueshme

- 41 **Aksionet e zakonshme potenciale trajtohen si të pakësueshme kur, dhe vetëm kur, konvertimi i tyre në aksione të zakonshme do të ulë fitimet për aksion ose do të rrisë humbjen për aksion nga operacionet e vazhdueshme.**
- 42 Njësia ekonomike përdor fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme që i takon njësisë ekonomike mëmë si numër kontrolli për të përcaktuar nëse aksionet e zakonshme potenciale janë të pakësueshme ose të kundër-pakësueshme. Fitimi ose humbja nga operacionet e vazhdueshme që i atribuohen njësisë ekonomike mëmë rregullohet në përputhje me paragrafin 12 dhe përjashton elementët që lidhen me operacionet jo të vazhdueshme.
- 43 Aksionet e zakonshme potenciale janë të kundër-pakësueshëm kur konvertimi i tyre në aksione të zakonshme do të rrisë fitimet për aksion ose do të ulë humbjen për aksion nga operacionet e vazhdueshme. Llogaritja e fitimeve të pakësuar për aksion nuk merr parasysh konvertimin, ushtrimin, ose emetime të tjera të aksioneve të zakonshme potenciale të cilat mund të kenë një efekt kundër-pakësues në fitimet për aksion.
- 44 Në përcaktimin nëse aksionet e zakonshme potenciale janë pakësuese ose kundër-pakësuese, çdo emetim ose seri e aksioneve të zakonshme potenciale merret në konsideratë veças dhe jo së bashku. Radha me të cilën merren në konsideratë aksionet e zakonshme potenciale mund të ndikojë nëse ato janë pakësuese ose jo. Për këtë, për të maksimizuar pakësimin e fitimeve bazë për aksion, secili emetim ose seri e aksioneve të zakonshme potenciale trajtohet sipas radhës nga ato më shumë të pakësueshëm deri tek ato më pak të pakësueshëm, d.m.th. aksionet e zakonshme potenciale të pakësueshme me ‘fitime për aksion rritëse’ më të ulta përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuar për aksion përpara atyre me fitime më të larta për aksione rritëse. Opsionet dhe garancitë në përgjithësi përfshihen përpara, sepse ato nuk ndikojnë në numëruesin e llogaritjes.

Opsionet, garancitë dhe ekuivalentët e tyre

- 45 **Për qëllimet e llogaritjes së fitimeve të pakësuar për aksion, një njësi ekonomike do të marrë parasysh ushtrimin e opsioneve dhe garancive të pakësueshme të njësisë ekonomike. Të ardhurat e supozuara nga këto instrumenta trajtohen sikur janë marrë prej emetimit të aksioneve të zakonshme me çmimin mesatar të tregut të aksioneve të zakonshme gjatë periudhës. Diferenca mes numrit të aksioneve të zakonshme të emetuara dhe numrit të aksioneve të zakonshme që do të duhej të emetoheshin me çmimin mesatar të tregut të aksioneve të zakonshme gjatë periudhës trajtohet si një emetim i aksioneve të zakonshme falas.**
- 46 Opsionet dhe garancitë janë të pakësueshme kur ato mund të rezultojnë në emetim të aksioneve të zakonshme për më pak se çmimi mesatar i tregut të aksioneve të zakonshme gjatë periudhës. Shuma e pakësimit është çmimi mesatar i tregut të aksioneve të zakonshme gjatë periudhës minus çmimin e emetimit. Për këtë, për të llogaritur fitimet e pakësuar për aksion, aksionet e zakonshme potenciale, trajtohen sikur janë edhe (a) edhe (b) më poshtë:
- (a) një kontratë për të emetuar një numër të caktuar të aksioneve të zakonshme me çmimin e tyre mesatar të tregut gjatë periudhës. Këto aksione të zakonshme supozohet se janë çmuar drejt dhe nuk janë as të pakësueshëm dhe as të kundër-pakësueshëm. Ato nuk merren parasysh në llogaritjen e fitimeve të pakësuar për aksion.

- (b) një kontratë për të emetuar falas aksione të zakonshme të mbetura. Këto aksione të zakonshme nuk gjenerojnë të ardhura dhe nuk kanë efekt në fitimin ose humbjen që i takon aksioneve të zakonshme në qarkullim. Prandaj, këto aksione janë të pakësueshme dhe i shtohen numrit të aksioneve të zakonshme në qarkullim në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion.
- 47 Opsionet dhe garancitë kanë efekt pakësues vetëm atëherë kur çmimi mesatar i tregut të aksioneve të zakonshme gjatë periudhës tejkalon çmimin e ushtrimit të opsioneve ose garancive (d.m.th. ato janë ‘të favorshme’). Fitimet për aksion të raportuara më parë nuk rregullohen në mënyrë retroaktive për të pasqyruar ndryshimet në çmimet e aksioneve të zakonshme.
- 47A Për opsionet e aksionit dhe marrëveshjet e tjera të pagesave me bazë aksionin për të cilat zbatohet SNRF 2 *Pagesat me bazë aksionin*, çmimi i emetimit i referuar në paragrafin 46 dhe çmimi i ushtrimit i referuar në paragrafin 47 duhet të përfshijnë vlerën e drejtë (i matur në përputhje me SNRF 2) të secilit prej mallrave ose shërbimeve që duhet t’i furnizohen njësisë ekonomike në të ardhmen sipas opsionit të aksionit ose marrëveshjeve të tjera të pagesave me bazë aksionin.
- 48 Opsionet e aksionit të punonjësve me kushte fikse ose të përcaktueshme dhe aksionet e zakonshme jo të dhëna trajtohen si opsione në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion, edhe kur ato mund të kushtëzohen në dhënie. Ato trajtohen si në qarkullim në datën e grantit. Opsionet e aksionit me bazë performancën e punonjësve trajtohen si aksione të emetueshme me kusht sepse emetimi i tyre varet nga plotësimi i kushteve të caktuara si shtesë e kalimit të kohës.

Instrumente të konvertueshme

- 49 Efekti pakësues i instrumenteve të konvertueshëm do të pasqyrohet në fitimet e pakësuara për aksion në përputhje me paragrafët 33 dhe 36.
- 50 Aksionet preferenciale të konvertueshme janë të kundër-pakësueshëm kurdoherë që shuma e dividendit të këtyre aksioneve në periudhën aktuale ose të akumuluar për aksionet e zakonshme të përfitueshme nga konvertimi tejkalon fitimet bazë për aksion. Në mënyrë të ngjashme, borxhi i konvertueshëm është i kundër-pakësueshëm kurdoherë që interesi i tij (neto nga tatimet dhe ndryshimet e tjera në të ardhura ose shpenzime) për aksionet e zakonshme të përfitueshme nga konvertimi tejkalon fitimet bazë për aksion.
- 51 Konvertimi me riblerje ose i detyruar i aksioneve preferenciale të konvertueshme mund të ndikojë vetëm në një pjesë të aksioneve preferenciale të konvertueshme që ishin më parë në qarkullim. Në këto raste, çdo tejkalim i shumës që i referohet paragrafi 17 i atribuohet atyre aksioneve që janë ri-përcaktuar ose konvertuar për qëllimet e përcaktimit nëse aksionet preferenciale të mbetura në qarkullim janë ose jo të pakësueshme. Aksionet e ri-përcaktuara ose të konvertuara trajtohen veças nga ato aksione që nuk janë ri-përcaktuar ose konvertuar.

Aksione të emetueshme me kusht

- 52 Si edhe në llogaritjen e fitimeve bazë për aksion, aksionet e zakonshme të emetueshme me kusht trajtohen si në qarkullim dhe përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion në qoftë se plotësohen kushtet (d.m.th. ngjarjet kanë ndodhur). Aksionet e emetueshme me kusht përfshihen nga fillimi i periudhës (ose nga data e marrëveshjes së aksionit me kusht, nëse kjo ndodh më vonë). Në qoftë se kushtet nuk plotësohen, numri i aksioneve të emetueshme me kusht të përfshira në llogaritjet e fitimeve të pakësuara për aksion bazohet në numrin e aksioneve që mund të jenë të emetueshme në qoftë se fundi i periudhës do të jetë edhe fundi i periudhës me kusht. Riparaqitja nuk lejohet në qoftë se nuk janë plotësuar kushtet në kohën kur ka skaduar periudha me kusht.
- 53 Në qoftë se marrja ose mbajtja e një shume të caktuar të fitimeve për një periudhë është kushti për emetimin me kusht dhe në qoftë se kjo shumë ka qenë marrë në fund të periudhës raportuese por duhet të mbahet përtej fundit të periudhës raportuese për një periudhë shtesë, atëherë, kur llogariten fitimet e pakësuara për aksion, aksionet e zakonshme shtesë trajtohen si në qarkullim, në qoftë se efekti është pakësues. Në këtë rast, llogaritja e fitimeve të pakësuara për aksion bazohet në numrin e aksioneve të zakonshme që do të ishin emetuar në qoftë se shuma e fitimeve në fund të periudhës raportuese ishte shuma e fitimeve në fund të periudhës me kusht. Për arsye se fitimet mund të ndryshojnë në periudhën e ardhshme, llogaritja e fitimeve bazë për aksion nuk përfshin këto aksione të zakonshme të emetueshme me kusht deri në fund të periudhës me kusht sepse nuk plotësohen të gjitha kushtet e nevojshme.
- 54 Numri i aksioneve të zakonshme të emetueshme me kusht mund të varet nga çmimi i ardhshëm i tregut të aksioneve të zakonshme. Në këtë rast, në qoftë se efekti është pakësues, llogaritja e fitimeve të pakësuara për aksion bazohet në numrin e aksioneve të zakonshme që duhet të ishin emetuar nëse çmimi i tregut në fund të periudhës raportuese do të ishte edhe çmimi i tregut në fund të periudhës me kusht. Në qoftë se kushti bazohet në një mesatare të çmimeve të tregut gjatë periudhës së kohës që shtrihet përtej fundit të

periudhës raportuese, përdoret mesatarja për periudhën e kohës që ka kaluar. Për arsye se çmimi i tregut mund të ndryshojë në periudhën e ardhshme, llogaritja e fitimeve bazë për aksion nuk përfshin këto aksione të zakonshme të emetueshme me kusht deri në fund të periudhës me kusht sepse nuk plotësohen të gjitha kushtet e nevojshme.

- 55 Numri i aksioneve të zakonshme të emetueshme me kusht mund të varet nga fitimet e ardhshme dhe çmimet e ardhshme të aksioneve të zakonshme. Në këto raste, numri i aksioneve të zakonshme që përfshihet në llogaritjet e fitimeve të pakësuara për aksion bazohet në të dyja kushtet (d.m.th. fitimet e deritanishme dhe çmimi aktual i tregut në fund të periudhës raportuese). Aksionet e zakonshme të emetueshme me kusht nuk përfshihen në llogaritjet e fitimeve të pakësuara për aksion përveç rastit kur plotësohen të dyja kushtet.
- 56 Në raste të tjera, numri i aksioneve të zakonshme të emetueshme me kusht varet nga një kusht i ndryshëm nga fitimet ose çmimi i tregut (për shembull, hapja e një numri të caktuar të magazinave të shitjes me pakicë). Në këto raste, duke supozuar se statusi aktual i kushtit mbetet i pandryshuar deri në fund të periudhës me kusht, aksionet e zakonshme të emetueshme me kusht përfshihen në llogaritjet e fitimeve të pakësuara për aksion në përputhje me statusin në fund të periudhës raportuese.
- 57 Aksionet e zakonshme potenciale të emetueshme me kusht(përveç atyre që mbulohen nga një marrëveshje aksioni me kusht, të tilla si instrumenta të konvertueshëm të emetueshme me kusht) përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion si më poshtë:
- (a) njësia ekonomike përcakton nëse aksionet e zakonshme potenciale mund të supozohen të jenë të emetueshme mbi bazën e kushteve të caktuara për emetimin e tyre në përputhje me dispozitat e aksionit të zakonshëm me kusht të paragrafëve 52-56; dhe
 - (b) në qoftë se këto aksione të zakonshme potenciale duhet të pasqyrohen në fitimet e pakësuara për aksion, njësia ekonomike përcakton ndikimin e tyre në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion duke ndjekur dispozitat për opsionet dhe garancitë në paragrafët 45-48, dispozitat për instrumentet e konvertueshëm në paragrafët 49-51, dispozitat për kontratat që mund të shlyhen me aksione të zakonshme ose mjete monetare në paragrafët 58-61, ose dispozita të tjera, cilat mund të jenë përshtatshme.

Megjithatë, ushtrimi ose konvertimi nuk merret parasysh për qëllimet e llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion përveç rasteve kur është marrë parasysh ushtrimi ose konvertimi i aksioneve të zakonshme potenciale në qarkullim të ngjashme që nuk janë të emetueshme me kusht.

Kontratat që mund të shlyhen me aksione të zakonshme ose me mjete monetare

- 58 **Kur njësia ekonomike ka emetuar një kontratë që mund të shlyhet me aksione të zakonshme ose me mjete monetare, kjo në opsion të njësisë ekonomike, ajo duhet të marrë parasysh që kontrata do të shlyhet me aksione të zakonshme dhe aksionet e zakonshme potenciale që rezultojnë duhet të përfshihen në fitimet e pakësuara për aksion nëse efekti është pakësues.**
- 59 Kur një kontratë e tillë paraqitet për qëllimet e kontabilizimit si një aktiv, ose një detyrim, ose ka një përbërës të kapitalit të vet dhe një përbërës të detyrimeve, njësia ekonomike rregullon numëruesin për çdo ndryshim në fitim ose humbje që do të kishte rezultuar gjatë periudhës nëse kontrata ka qenë klasifikuar e gjitha si një instrument i kapitalit të vet. Ky rregullim është i ngjashëm me rregullimet që kërkohen në paragrafin 33.
- 60 **Për kontratat që mund të shlyhen me aksione të zakonshme ose mjete monetare, kjo në opsion të zotëruesit, për llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion duhet të përdoret shlyerja në mjete monetare dhe shlyerja me aksione që është më shumë pakësuese.**
- 61 Një shembull i një kontrate që mund të shlyhet me aksione të zakonshme ose mjete monetare është një instrument borxhi që, në maturim, i jep njësisë ekonomike të drejta të pakufizuara që të shlyejë shumën e principalit me mjete monetare ose me aksione të zakonshme të vetat. Shembull tjetër është një opsion për të shitur me shkrim që i jep të drejtën zotëruesit të zgjedhë shlyerjen me aksione të zakonshme ose mjete monetare.

Opsione të blera

- 62 Kontratat e tilla si opsionet e blera për të shitur dhe opsionet e blera për të blerë (d.m.th. opsionet e mbajtura nga njësia ekonomike në aksionet e veta të zakonshme) nuk përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion sepse përfshirja e tyre do të ishte kundër-pakësuese. Opsioni për të shitur duhet të ushtrohet vetëm nëse çmimi i ushtrimit ka qenë më i lartë se sa çmimi i tregut dhe opsioni për të blerë duhet të ushtrohet vetëm nëse çmimi i ushtrimit ka qenë më i ulët se sa çmimi i tregut.

Opsionet për të shitur me shkrim

- 63 Kontratat të cilat kërkojnë nga njësia ekonomike që të riblerë aksionet e veta, të tilla si opsionet për të shitur me shkrim dhe kontratat e blerjes të ardhshme, pasqyrohen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion nëse efekti është pakësues. Në qoftë se këto kontrata janë ‘të favorshme’ gjatë periudhës (d.m.th. çmimi i ushtrimit ose shlyerjes është mbi çmimin mesatar të tregut për atë periudhë), efekti i mundshëm pakësues në fitimet për aksion duhet të llogaritet si më poshtë:
- (a) do të supozohet se në fillim të periudhës do të emetohen mjaftueshëm aksione të zakonshme (me çmimin mesatar të tregut gjatë periudhës) për të ngritur të ardhura për të plotësuar kontratën;
 - (b) do të supozohet se të ardhurat nga emetimi përdoren për të plotësuar kontratën (d.m.th. për të riblerë aksionet e zakonshme); dhe
 - (c) aksionet e zakonshme rritëse (diferenca mes numrit të aksioneve të zakonshme të supozuara si të emetuara dhe numrit të aksioneve të zakonshme të marra nga plotësimi i kontratës) do të përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion.

Rregullimet retrospektive

- 64 Në qoftë se numri i aksioneve të zakonshme ose aksioneve të zakonshme potenciale në qarkullim rritet si rezultat i një emetimi kapitalizimi, emetimi bonusi ose shpërbërje aksioni, ose ulet si rezultat i një anulimi të shpërbërjes së aksionit, llogaritja e fitimeve bazë dhe fitimeve të pakësuara për aksion për të gjitha periudhat e paraqitura duhet të rregullohet retrospektivisht. Në qoftë se këto ndryshime ndodhin pas periudhës raportuese por përpara se të miratohen për publikim pasqyrat financiare, llogaritjet për aksion për këto pasqyra dhe për pasqyrat financiare të paraqitura për periudhat e mëparshme duhet të bazohen në numrin e ri të aksioneve. Fakti që llogaritjet për aksion pasqyrojnë këto ndryshime në numrin e aksioneve do të sqarohet në dhënien e informacioneve shpjeguese. Më tej, fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion për të gjitha periudhat e paraqitura do të rregullohen për efektet e gabimeve dhe rregullimeve që rezultojnë nga ndryshimet në politikat kontabël që kontabilizohen retrospektivisht.
- 65 Njësia ekonomike nuk riparaqet fitimet e pakësuara për aksion të secilës periudhë të mëparshme të paraqitur për ndryshimet në supozimet e përdorura në llogaritjet e fitimeve për aksion ose për konvertimin e aksioneve të zakonshme potenciale në aksione të zakonshme.

Paraqitja

- 66 Njësia ekonomike paraqet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, fitimet bazë dhe fitimet e pakësuara për aksion për fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë dhe për fitimin ose humbjen që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm të njësisë ekonomike mëmë për periudhën për secilën klasë të aksioneve të zakonshme që ka të drejta të ndryshme në ndarjen e fitimit për periudhën. Një njësi ekonomike paraqet fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion me rëndësi të barabartë për të gjitha periudhat e paraqitura.
- 67 Fitimet për aksion paraqiten për çdo periudhë për të cilën paraqitet një pasqyrë të ardhurash gjithëpërfshirëse. Në qoftë se fitimet e pakësuara për aksion raportohen për të paktën një periudhë, ato do të raportohen për të gjitha periudhat e paraqitura, edhe nëse ato janë të barabarta me fitimet bazë për aksion. Në qoftë se fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion janë të barabarta, paraqitja e të dyjave mund të bëhet në një rresht të pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse.
- 67A Nëse njësia ekonomike paraqet zëra të fitimit ose humbjes në një pasqyrë të veçantë të fitimit ose humbjes nga pasqyra që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse siç përshkruhet në paragrafin 12(b) të SNRF 18, ajo paraqet fitimet bazë dhe fitimet e pakësuara për aksion, siç kërkohet në paragrafët 66 dhe 67, në pasqyrën e fitimit ose humbjes.
- 68 Njësia ekonomike që raporton një operacion jo të vijueshëm ose paraqet shumat bazë dhe të pakësuara për aksion për operacionin jo të vijueshëm në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, ose e jep si informacion shpjegues në shënimet.
- 68A Nëse një njësi ekonomike paraqet zëra të fitimit ose humbjes në një pasqyrë të veçantë të fitimit ose humbjes nga pasqyra që paraqet të ardhurat gjithëpërfshirëse siç përshkruhet në paragrafin 12(b) të SNRF

18, ajo paraqet fitimet bazë dhe fitimet e pakësuara për aksion për operacionin jo të vijueshëm, siç kërkohet në paragrafin 68, në pasqyrën e fitimit ose humbjes ose e jep si informacion shpjegues në shënimet.

- 69 Njësia ekonomike paraqet fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion, edhe nëse shumat janë negative (d.m.th. një humbje për aksion).

Dhënia e informacioneve shpjeguese

- 70 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese vijuese:

- (a) shumat e përdorura si numërues në llogaritjen e fitimeve bazë dhe të pakësuara për aksion, dhe një rakordim të këtyre shumave me fitimin ose humbjen që i takon njësisë ekonomike mëmë për periudhën. Rakordimi përfshin efektin individual për secilën klasë të instrumenteve që ndikon në fitimet për aksion.
- (b) numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme të përdorur si emërues i përbashkët në llogaritjen e fitimeve bazë dhe fitimeve të pakësuara për aksion, dhe rakordin e këtyre emëruesve me njëri tjetrin. Rakordimi përfshin efektin individual për secilën klasë të instrumenteve që ndikon në fitimet për aksion.
- (c) instrumentet (përfshirë aksionet e emetueshme me kusht) që kanë mundësi të pakësojnë fitimet bazë për aksion në të ardhmen, por që nuk janë përfshirë në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion sepse ato janë kundër-pakësuese për periudhën (at) e paraqitur.
- (d) një përshkrim të transaksioneve me aksione të zakonshme ose të transaksioneve me aksione të zakonshme potenciale, përveç atyre të kontabilizuara në përputhje me paragrafin 64, që ndodhin pas periudhës raportuese dhe të cilat do të ndryshonin në mënyrë të ndjeshme numrin e aksioneve të zakonshme ose aksioneve të zakonshme potenciale në qarkullim në fund të periudhës në qoftë se këto transaksione do të kishin ndodhur para përfundimit të periudhës raportuese.

- 71 Shembuj të transaksioneve të përmendura në paragrafin 70(d) përfshijnë:

- (a) një emetim aksionesh për mjete monetare;
- (b) një emetim i aksioneve kur të ardhurat përdoren për të paguar borxhin ose aksionet preferenciale në qarkullim në fund të periudhës raportuese;
- (c) riblerja e aksioneve të zakonshme në qarkullim;
- (d) konvertimi ose ushtrimi i aksioneve të zakonshme potenciale në qarkullim në fund të periudhës raportuese me aksione të zakonshme;
- (e) një emetim i opsioneve, garancive, ose instrumenteve të konvertueshëm; dhe
- (f) plotësimi i kushteve të cilat mund të rezultojnë në emetimin e aksioneve të emetueshme me kusht.

Shumat e fitimeve për aksion nuk rregullohen për ato transaksione që ndodhin mbas datës së raportimit sepse këto transaksione nuk ndikojnë në shumën e kapitalit të përdorur për të prodhuar fitimin ose humbjen e periudhës.

- 72 Instrumentet financiarë dhe kontratat e tjera që gjenerojnë aksione të zakonshme potenciale mund të kenë afate dhe kushte që ndikojnë në matjen e fitimeve bazë dhe fitimeve të pakësuara për aksion. Këto afate dhe kushte mund të përcaktojnë nëse ndonjë nga aksionet e zakonshme potenciale është pakësues dhe, nëse është kështu, efektin në numrin mesatar të ponderuar të aksioneve në qarkullim dhe çdo rregullim vijues në fitimin ose humbjen që i takon zotëruesve të kapitalit të zakonshëm. Inkurajohet dhënia e informacioneve shpjeguese për afatet dhe kushtet e këtyre instrumenteve financiarë dhe kontratat e tjera, në qoftë se kjo nuk kërkohet (shih SNRF 7 *Instrumentet financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese*).

- 73- 73A [Fshirë]

- 73B Përveç paraqitjes së fitimeve bazë dhe fitimeve të pakësuara për aksion të kërkuar nga ky Standard, njësisë ekonomike i lejohet të japë si informacion shpjegues në shënimet, shumat shtesë për aksion duke përdorur një matës performance si numërues të ndryshëm nga ai i kërkuar nga paragrafët 12–18 dhe 33–35. Megjithatë, një numërues i tillë (ose numëruesit) do të jetë shuma(at) që u takon mbajtësve të zakonshëm të kapitalit neto të njësisë ekonomike mëmë nga:

- (a) një total ose nëntotal (i cilësuar) në paragrafët 69, 86 dhe 118 të SNRF 18; ose
- (b) një matës performance i përcaktuar nga drejtimi, siç përkufizohet në paragrafin 117 të SNRF 18.

- 73C Nëse kur zbaton paragrafin 73B, njësia ekonomike jep si informacion shpjegues një shumë shtesë për aksion, ajo duhet:
- (a) të japë si informacion shpjegues edhe shumën shtesë bazë dhe të pakësuara për aksion me rëndësi të barabartë.
 - (b) të llogarisë shumën shtesë për aksion duke përdorur numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme të përcaktuar në përputhje me këtë Standard.
 - (c) të japë informacion shpjegues në shënimet mbi shumën shtesë për aksion. Ky informacion nuk mund të paraqitet në pasqyrat financiare kryesore.
 - (d) të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 121–125 të SNRF 18 për numëruesit që janë matës performance të përcaktuar nga drejtimi.

Data e hyrjes në fuqi

- 74 Njësia ekonomike do të zbatojë këtë standard për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2005 e në vijim. Inkurajohet zbatimi i menjëhershëm. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë Standard për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2005, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.
- 74A SNK 1 (rishikuar në 2007) ndryshoi terminologjinë e përdorur në të gjithë SNRF-të. Përveç kësaj, ai shtoi paragrafët 4A, 67A, 68A dhe 73A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore nga 1 janar 2009 e në vazhdim. Nëse një njësi ekonomike zbaton SNK 1 (rishikuar në 2007) për një periudhë më të hershme, ndryshimet do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.¹
- 74B Si rezultat i SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, janë ndryshuar paragrafët 4, 40 dhe A11. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.
- 74C Si rezultat i SNRF 13, i publikuar në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 8, 47A dhe A2. Njësia ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 13.
- 74D *Paraqitja e zërave në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse* (Ndryshimet ndaj SNK 1), publikuar më qershor 2011, ndryshoi paragrafët 4A, 67A, 68A dhe 73A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime kur ajo zbaton SNK 1 e ndryshuar në qershor 2011.²
- 74E SNRF 9 *Instrumente financiare* e publikuar në korrik 2014 ka ndryshuar paragrafin 34. Njësia ekonomike e zbaton këtë ndryshim kur ajo zbaton SNRF 9.
- 74F SNRF 18 i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafët 4A, 13 dhe 67A–68A, shtoi paragrafët 73B–73C dhe fshihi paragrafët 73–73A. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

Shfuqizimi i deklaratave të tjera

- 75 Ky Standard zëvendëson SNK 33 *Fitimet për aksion* (publikuar në 1997).
- 76 Ky Standard zëvendëson KIS-24 *Fitimet për aksion – Instrumentet financiarë dhe kontratat e tjera që mund të shlyhen me aksione*.

¹ Në prill 2024, BSNK publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* dhe mbarti këto kërkesa të SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* tek SNRF 18.

² Kur publikoi SNRF18, BSNK mbarti këto kërkesa të SNK 1 tek SNRF 18.

Shtojca A

Udhëzime të zbatimit

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Fitimi ose humbja që takon njësisë ekonomike mëmë

- A1 Për qëllimet e llogaritjes së fitimeve për aksion bazuar në pasqyrat financiare të konsoliduara, fitimi ose humbja që i takon njësisë ekonomike mëmë paraqitet në fitimin ose humbjen e njësisë ekonomike të konsoliduar mbasi rregullohet për interesat minoritare.

Emetimet e të drejtave

- A2 Emetimi i aksioneve të zakonshme në kohën e ushtrimit ose konvertimit të aksioneve të zakonshme potenciale në përgjithësi nuk krijon një element bonusi. Kjo sepse aksionet e zakonshme potenciale emetohen në përgjithësi për vlerën e plotë, që rezulton në një ndryshim proporcional të burimeve të disponueshme nga njësia ekonomike. Në emetimin e të drejtave, megjithatë, çmimi i ushtrimit shpesh është më i ulët se vlera e drejtë e aksioneve. Prandaj, siç përmendet në paragrafin 27(b), të tilla emetime të të drejtave përfshijnë një element bonusi. Në qoftë se një emetim i të drejtave ofrohet për të gjithë aksionarët ekzistues, numri i aksioneve të zakonshme për t'u përdorur në llogaritjen e fitimeve bazë dhe fitimeve të pakësuarra për aksion për të gjitha periudhat përpara emetimit të të drejtave është numri i aksioneve të zakonshme në qarkullim para emetimit, i shumëzuar me faktorin e mëposhtëm:

Vlera e drejtë për aksion menjëherë përpara ushtrimit të të drejtave

Vlera e drejtë për aksion teorikisht pa të drejtat

Vlera e drejtë për aksion teorikisht pa të drejtat llogaritet duke mbledhur vlerën e tregut të përgjithshme të aksioneve menjëherë përpara ushtrimit të të drejtave me të ardhurat nga ushtrimi i të drejtave, dhe duke i pjestuar me numrin e aksioneve në qarkullim mbas ushtrimit të të drejtave. Kur të drejtat tregtohen në publik veças nga aksionet përpara datës së ushtrimit, vlera e drejtë për qëllimet e kësaj llogaritje përcaktohet sa më afër ditës së fundit në të cilën janë tregtuar aksionet së bashku me të drejtat.

Numri i Kontrollit

- A3 Për të ilustruar zbatimin e nocionit të numrit të kontrollit të përshkruar në paragrafët 42 dhe 43, supozojmë se një njësi ekonomike ka fitim nga operacionet e vazhdueshme që i takon njësisë ekonomike mëmë për 4,800 NjM,³ një humbje nga operacionet jo të vazhdueshme që i takon njësisë ekonomike mëmë për (7,200 NjM), një humbje që i takon njësisë ekonomike mëmë për (2,400 NjM), dhe 2,000 aksione të zakonshme dhe 400 aksione të zakonshme potenciale në qarkullim. Fitimet bazë për aksion të njësisë ekonomike janë 2.40 NjM nga operacionet e vazhdueshme, (3.60 NjM) nga operacionet jo të vazhdueshme dhe (1.20 NjM) nga humbja. 400 aksionet e zakonshme potenciale përfshihen në fitimet e pakësuarra për aksion sepse rezultojnë me 2.00 NjM fitime për aksion nga operacionet e vazhdueshme që janë pakësues, duke supozuar se këto 400 aksione të zakonshme potenciale nuk kanë ndikim në fitim ose në humbje. Për arsye se fitimi nga operacionet e vazhdueshme që i takon njësisë ekonomike mëmë është numër kontrolli, njësia ekonomike përfshin këto 400 aksione të zakonshme potenciale në llogaritjen e shumave të tjera të fitimeve për aksion, edhe pse kështu shumat që rezultojnë të fitimeve për aksion janë kundër-pakësuese kundrejt shumave të fitimeve bazë për aksion të krahasueshme me to, d.m.th. se humbja për aksion është më e ulët (3.00 NjM) për aksion humbje nga operacionet jo të vazhdueshme dhe (1.00 NjM) për aksion humbje.

Çmimi mesatar i tregut të aksioneve të zakonshme

- A4 Për qëllimet e llogaritjes së fitimeve të pakësuarra për aksion, çmimi mesatar i tregut të aksioneve të zakonshme që supozohet se janë emetuar llogaritet mbi bazën e çmimit mesatar të tregut të aksioneve të zakonshme gjatë periudhës. Teorikisht, çdo transaksion i tregut për aksionet e zakonshme të njësisë

³ Në këtë udhëzues, shumat monetare janë emëruar në 'Njësi Monetare' (NjM).

ekonomike mund të përfshihet në përcaktimin e çmimit mesatar të tregut. Megjithatë nga ana praktike, është zakonisht e përshtatshme një mesatare e thjeshtë e çmimeve javore ose mujore.

- A5 Në përgjithësi, çmimet e mbylljes së tregut janë të përshtatshme për llogaritjen e çmimit mesatar të tregut. Megjithatë, kur çmimet luhaten shumë, një mesatare e çmimeve të larta me ato të ulta prodhon një çmim më përfaqësues. Metoda e përdorur për të llogaritur çmimin mesatar të tregut përdoret në mënyrë të qëndrueshme përveç rasteve kur ajo nuk është më përfaqësuese për arsye të ndryshimeve të kushteve. Për shembull, një njësi ekonomike që përdor çmimet e mbylljes së tregut për të llogaritur çmimin mesatar të tregut prej disa vjetësh me çmime relativisht stabël, mund të ndryshojë atë me çmimet e larta dhe të ulta nëse çmimet fillojnë të luhaten shumë dhe çmimet e mbylljes së tregut nuk prodhojnë më një çmim mesatar përfaqësues.

Opsionet, garancitë dhe ekuivalentët e tyre

- A6 Opsionet ose garancitë për të blerë instrumenta të konvertueshëm supozohet se ushtrohen për të blerë instrumentet e konvertueshëm kurdoherë që çmimet mesatare edhe të instrumentit të konvertueshëm edhe të aksioneve të zakonshme të përfitueshme nga konvertimi të jenë mbi çmimin e ushtrimit të opsioneve ose garancive. Megjithatë, ushtrimi nuk supozohet përveç rasteve, nëse ka të tillë, të konvertimit të instrumenteve të ngjashëm të konvertueshëm në qarkullim.
- A7 Opsionet ose garancitë mund të lejojnë ose të kërkojnë tenderimin e borxhit ose instrumenteve të tjerë të njësisë ekonomike (ose të mëmës së tij ose të një filiali) në pagimin e të gjithë ose të një pjese të çmimit të ushtrimit. Në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion, këto opsione ose garanci kanë një efekt pakësues në qoftë se (a) çmimi mesatar i tregut i aksioneve përkatëse të zakonshme për periudhën tejkalon çmimin e ushtrimit ose (b) çmimi i shitjes i instrumentit për t'u tenderuar është më i ulët se ai me të cilin instrumenti mund të tenderohet sipas marrëveshjes së opsionit ose garancisë dhe zbritja që rezulton përcakton një çmim ushtrimi efektiv poshtë çmimit të tregut të aksioneve të zakonshme të përfitueshme nga ushtrimi. Në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion, këto opsione ose garanci supozohet se ushtrohen dhe se borxhi ose instrumentet e tjerë supozohet se janë tenderuar. Në qoftë se tenderimi i mjeteve monetare është më i favorshëm për zotëruesin e opsionit ose garancisë dhe kontrata lejon tenderimin e mjeteve monetare, atëherë supozohet tenderimi i mjeteve monetare. Interesi (neto nga tatimi) për çdo borxh të supozuar për t'u tenderuar i shtohet mbrapsht si një rregullim në numërues.
- A8 Trajtim i ngjashëm u bëhet aksioneve preferenciale që kanë dispozita të ngjashme ose instrumenteve të tjerë që kanë opsione konvertimi që lejojnë investitorin të paguajë mjete monetare për një normë konvertimi më të favorshme.
- A9 Kushtet mbështetëse të disa opsioneve ose garancive mund të kërkojnë që përfitimet e marra nga ushtrimi i këtyre instrumenteve të zbatohen në ripërcaktimin e borxhit ose instrumenteve të tjerë të njësisë ekonomike (ose të mëmës së saj ose një filiali). Në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion, këto opsione ose garanci supozohet se janë ushtruar dhe përfitimet përdoren për të blerë borxhin me çmimin e tij mesatar të tregut dhe jo për të blerë aksione të zakonshme. Megjithatë, të ardhurat e marra më tepër nga ushtrimi i supozuar kundrejt shumës së përdorur për blerjen e supozuar të borxhit merren në konsideratë (d.m.th. supozohet se janë përdorur për të blerë mbrapsht aksione të zakonshme) në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion. Interesi (neto nga tatimi) për çdo borxh të supozuar për t'u blerë i shtohet mbrapsht si një rregullim në numërues.

Opsionet për të shitur me shkrim

- A10 Për të ilustruar zbatimin e paragrafit 63, supozojmë se një njësi ekonomike ka në qarkullim 120 opsione për të shitur me shkrim aksionet e saja të zakonshme me një çmim ushtrimi prej 35 NjM. Çmimi mesatar i tregut i aksioneve të saja të zakonshme për periudhën është 28 NjM. Në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion, njësi ekonomike supozon se ajo ka emetuar 150 aksione me 28 NjM për aksion në fillim të periudhës për të plotësuar detyrimin e saj për të shitur për 4,200 NjM. Diferenca mes 150 aksioneve të zakonshme të emetuara dhe 120 aksioneve të zakonshme të marra nga plotësimi i opsionit për të shitur (30 aksione të zakonshme rritëse) i shtohet emëruesit në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion.

Instrumentet e filialeve, sipërmarrjeve të përbashkëta ose pjesëmarrjeve

- A11 Aksionet e zakonshme potenciale të një filiali, sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrje, të konvertueshme qoftë në aksione të zakonshme të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes, ose qoftë në aksione të zakonshme të mëmës, sipërmarrësit ose investitorit (njësia ekonomike raportuese), përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion si më poshtë:

- (a) instrumentet e emetuar nga një filial, sipërmarrje e përbashkët ose pjesëmarrje që i mundësojnë zotëruesit të tyre të përfitojë aksione të zakonshme të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes, përfshihen në të dhënat e llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes. Këto fitime për aksion pastaj përfshihen në llogaritjet e fitimeve për aksion të njësisë ekonomike raportuese bazuar në mbajtjen nga njësisë ekonomike raportuese të instrumenteve të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes.
- (b) instrumentet e një filiali, sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrjes që janë të konvertueshme në aksione të zakonshme të njësisë ekonomike raportuese merren parasysh në aksionet e zakonshme potenciale të njësisë ekonomike raportuese për qëllimet e llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion. Në mënyrë të ngjashme, opsionet ose garancitë e emetuara nga një filial, sipërmarrje e përbashkët ose pjesëmarrje për të blerë aksione të zakonshme të njësisë ekonomike raportuese merren parasysh në aksionet e zakonshme potenciale të njësisë ekonomike raportuese në llogaritjen e fitimeve të pakësuara të konsoliduara për aksion.
- A12 Për qëllimet e përcaktimit të fitimeve për aksion efekti i instrumenteve të emetuar nga një njësi ekonomike raportuese që janë të konvertueshme në aksione të zakonshme të një filiali, sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrje, instrumentet supozohen se janë konvertuar dhe numëruesi (fitimi ose humbja që i takon zotëruesve të aksioneve të zakonshme të njësisë ekonomike mëmë) rregullohet siç nevojitet në përputhje me paragrafin 33. Si shtesë e këtyre rregullimeve, numëruesi rregullohet për çdo ndryshim në fitimin ose humbjen e regjistruar nga njësisë ekonomike mëmë (të tilla si të ardhurat e dividendit ose të ardhurat me metodën e kapitalit të vet) që i takon rritjes në numrin e aksioneve të zakonshme në qarkullim të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes si rezultat i konvertimit të supozuar. Emëruesi i llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion nuk ndikohet sepse numri i aksioneve të zakonshme në qarkullim të njësisë ekonomike raportuese nuk do të ndryshojë sipas konvertimit të supozuar.

Pjesëmarrje në instrumente të kapitalit të vet dhe aksionet e zakonshme me dy klasa

- A13 Kapitali i vet i disa njësive ekonomike përfshin:
- (a) instrumenta që marrin pjesë në dividendë të aksioneve të zakonshme në përputhje me një formulë të paracaktuar (për shembull, dy për një), ndonjëherë, me kufij të sipërm për shtrirjen e pjesëmarrjes (për shembull, deri në, por jo më tepër se, një shumë e caktuar për aksion).
- (b) një klasë të aksioneve të zakonshme me normë dividendi të ndryshëm nga ai i një klase tjetër të aksioneve të zakonshme por pa të drejta paraprake ose eprore.
- A14 Për qëllimet e llogaritjes së fitimeve të pakësuara për aksion, supozohet konvertimi për këto instrumenta siç përshkruhet në paragrafin A13 që janë të konvertueshme në aksione të zakonshme në qoftë se efekti është pakësues. Për ato instrumenta që nuk janë të konvertueshme në një klasë të aksioneve të zakonshme, fitimi ose humbja e periudhës shpërndahet në klasat e ndryshme të aksioneve dhe instrumenteve të kapitalit të vet të pjesëmarrjeve në përputhje me të drejtat e dividendit të tyre ose të drejta të tjera për të marrë pjesë në fitimet e pashpërndara. Për të llogaritur fitimet bazë dhe të pakësuara për aksion:
- (a) fitimi ose humbja që i takon zotëruesve të kapitalit të vet të njësisë ekonomike mëmë rregullohet (fitimi i ulur dhe humbja e rritur) me shumën e dividendëve të deklaruar në atë periudhë për secilën klasë të aksioneve dhe me shumën kontraktuale të dividendëve (ose interesit nga obligacionet pjesëmarrëse) që duhet të paguhet për periudhën (për shembull, dividendët e akumuluar të papaguar).
- (b) fitimi ose humbja e mbetur shpërndahet për aksionet e zakonshme dhe instrumentet pjesëmarrëse në kapitalin e vet për aq sa secili instrument merr pjesë në fitime sikur i gjithë fitimi ose humbja e periudhës ka qene shpërndarë. Fitimi ose humbja totale e shpërndarë për secilën klasë të instrumenteve të kapitalit të vet përcaktohet duke shtuar shumën e shpërndarë për dividendë dhe shumën e shpërndarë për cilësinë e pjesëmarrjes.
- (c) shuma totale e fitimit ose humbjes e shpërndarë për secilën klasë të instrumenteve të kapitalit të vet pjesëtohet me numrin e instrumenteve në qarkullim për të cilat shpërndahen fitimet për të përcaktuar fitimet për aksion për instrument.

Për llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion, të gjitha aksionet e zakonshme potenciale që supozohet se janë emetuar përfshihen në aksionet e zakonshme në qarkullim.

Aksionet e paguara pjesërisht

- A15 Kur janë emetuar aksione të zakonshme por nuk janë paguar plotësisht, ato trajtohen në llogaritjen e fitimeve bazë për aksion si një fraksion i një aksioni të zakonshëm për aq sa kanë të drejtën të marrin pjesë në dividendë gjatë periudhës në raport me një aksion të zakonshëm të paguar plotësisht.
- A16 Për aq sa aksionet e paguara pjesërisht nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në dividendë gjatë periudhës, ato trajtohen si ekuivalentë të garancive ose opsioneve në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion. Teprica e pa paguar supozohet të paraqesë të ardhura të përdorura për të blerë aksione të zakonshme. Numri i aksioneve i përfshirë në fitimet e pakësuara për aksion është diferenca mes numrit të aksioneve të nënshkruara dhe numrit të aksioneve të supozuara për t'u blerë.